

SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**Forca Tokësore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Teknik i mesëm elektrikist	Rep. ushtarak nr.1040 në FT.	Zall-Herr Tiranë.	E pacaktuar	Me dosje	Nuk aplikohet	01.07.2020	15.07.2020

Formulari nr.1

1. Pozicioni i punës:	“Teknik i mesëm (Elektrikist)”, në skuadrën e shërbimeve, në togën e mbështetjes me shërbime, në kompaninë e mbështetjes, në repartin ushtarak nr.1040 në Forcën Tokësore.
2. Kodi i pozicionit:	C2
3. Reparti/Institucioni:	Reparti ushtarak nr.1040 në Forcën Tokësore.
4. Vendi:	Zall-Herr, Tiranë.
5. Paga:	VKM Nr. 202 datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.717 datë 23.06.2009”, “Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar.
7. Data e fillimit të aplikimit:	01.07.2020
8. Data e mbylljes së aplikimit:	15.07.2020
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Dokumentat e aplikimit:	- Kërkesë. - Formularin e aplikimit. - Fotokopje të kartës së identitetit. - Diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal. - Fotokopje të lejes së drejtimit të automjetit nëse ka. - Dëshmi profesioni nëse ka. - Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja nëse ka. - Raport mjekësor. - Fotografi me përmasa 4x6, 2-copë. - Dëshmi penaliteti. - Vërtetim nga Gjykata. - Vërtetim nga Prokuroria. - Librezë pune. - Jetëshkrimin CV. - Formularin e vetëdeklarimit.
11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:	- Të ketë shtetësinë shqiptare. - Të jetë jo më pak se 18-vjeç. - Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar. - Të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara. - Të jetë i aftë për punë nga ana shëndetsore. - Të mos jetë dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi. - Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda një viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Civil, C2.
- b. Arsimi : Të ketë kryer arsimin e mesëm në profilin “Elektrike”.
- c. Kualifikimi: Të ketë përvojë pune dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara.
Të ketë aftësi shumë të mira organizuese dhe komunikuese.
- d. Trajnimi: Të jetë i paisur me dëshmi përkatëse për profesionin e kërkuar.
- e. Eksperienca në punë: Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon.
- f. Gjuha e huaj: -----
- g. Kërkesa të tjera specifike:
 - Të ketë kurse kualifikimi për specialitetin e kërkuar.
 - Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: -----

13. Përshkrimi i punës:

- a. Detyrat kryesore: “Teknik i mesëm elektrikist”, në skuadrën e shërbimeve, në togën e mbështetjes me shërbime, në kompaninë e mbështetjes, në repartin ushtarak nr.1040, bën dhe mban përgjegjësi:
 - Të njohë të gjitha dispozitat ligjore dhe kërkesat e rregulloreve, që kanë të bëjnë me punën e tij dhe ti zbatojë ato me rigoroze.
 - Të njohë dokumentacionin e rrjetit elektrik dhe të paisjeve.
 - Të kontrollojë çdo ditë rrjetin e brendshëm e të jashtëm elektrik e të marrë masa përkatëse për riparimin e defekteve që kostatohen.
 - Të administrojë e të evidentojë në kartelën përkatëse, të gjitha paisjet, materialet që ka në ngarkim si dhe paisjet elektrike të ambienteve të jashtme.
- b. Përgjegjësitë: Përgjigjet për skemat elektrike të rrjetit e paisjeve, funksionimin, defektet që lindin, shkakët e të bëjë riparimet e tyre.

14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- Përzgjedhjen paraprake.
- Vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Tokësore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Komisioni verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Kandidatët që plotëojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- Vlerësimin e dokumentave të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës, të lidhura me fushën përkatëse).

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës, do të lidhet kontrata individuale e punës.